



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 113 Prot

Tiranë, më 12, 07, 2012

VENDIM Nr. 206, dt. 12.07.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.07.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik për Projektin: Ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan, Loti 1", paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan, Loti 1" realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Tiranë.
- II. Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) duhet të njoftojë fillimin e punimeve për ndërtimin e këtij Loti, si dhe të mundësojë logjistikën e nevojshme në mënyrë që ASHA dhe DRKK Tiranë të sigurojnë prezencë të vazhdueshme të ekspertëve arkeologë për realizimin e mbikëqyrjes arkeologjike gjatë zbatimit të projektit.
- III. Në projektet që do të ndërmarrë në të ardhmen, ARRSH të mundësojë përfshirjen e një arkeologu në ekipin e mbikëqyrjes së punimeve për fazën e ndërtimit të veprave të artit dhe gërmimeve, duke përballuar shpenzimet nga vlera
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Bruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al